

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA" PRISHTINË**

**FAKULTETI I EDUKIMIT FIZIK DHE I SPORTIT**



## **PUNIM MASTER**

**Tema: Dallimet në mes të nxënësve nga pjesa urbane dhe rurale në hapësirën antropometrike, motorike dhe motoriken specifike të rëndësishme për hendboll**

***Diferences on anthropometric, motoric and specifik motoric areas between students of urban and rural areas in Handball***

**MENTORI:**

**Dr. Afrim Koca**

**KANDIDATËT:**

**Ekrem Franca**

**&**

**Visar Hoxha**

**Prishtinë, 2018**

## PËRMBAJTJA

<b>1. HYRJE</b> .....	3
1.1 <i>Hulumtimet e deritanishme</i> .....	4
<b>2. QËLLIMI I PUNIMIT</b> .....	8
2.1 <i>Hipotezat themelore</i> .....	9
<b>3. METODAT E PUNËS</b> .....	9
3.1 <i>Mënyra e zbatimit të punimit</i> .....	9
3.1.1 <i>Sistemi i variablave antropometrike</i> .....	11
3.1.2 <i>Sistemi i variablave të motorikes bazike dhe motorikes specifike</i> .....	15
3.2 <i>Metodat dhe përpunimi i rezultateve</i> .....	22
<b>4. Metodat dhe përpunimi i rezultateve</b> .....	22
<b>5. REZULTAT DHE DISKUTIMET</b> .....	23
5.1 Parametrat themelore statistikore të matjeve antropometrike të nxënësve nga viset urbane dhe rurale të komunës së Drenasit .....	23
5.1.1 <i>Rezultatet e parametrave themelor statistikor në hapësirën antropometrike urbane</i> .....	23
5.1.2 <i>Rezultatet e parametrave themelor statistikor të variablave motorikes bazike dhe specifike urbane</i> .....	25
5.1.3 <i>Rezultatet e parametrave themelor statistikor në hapësirën antropometrike te viseve rurale</i> .....	27
5.1.4 <i>Rezultatet e parametrave themelor statistikor të variablave motorike dhe specifike rurale</i> .....	29
5.2 Korrelacionet ndërmjet rezultateve të nxënësve nga viset urbane dhe rurale të komunës së Drenasit .....	31
5.2.1 <i>Koeficientet e korrelacioneve të variablave antropometrike urbane</i> .....	31
5.2.2 <i>Koeficientet korrelacioneve të variablave motorike bazike dhe specifike urbane</i> .....	32
5.2.3 <i>Koeficientet e korrelacioneve të variablave antropometrike rurale</i> .....	33

5.2.4 Koeficientet korrelacioneve të variablave motorike bazike dhe specifike rurale .....	34
<b>5.3 KROSKORELACIONET NË MES TË VARIABLAVE ANTROPOMETRIKE DHE MOTORIKE .....</b>	<b>35</b>
5.3.1 Kroskorelacionet ndërmjet variablave antropometrike dhe motorike në hapësiren manifeste të nxënësve nga viset urbane .....	35
5.3.2 Kroskorelacionet ndërmjet variablave antropometrike dhe motorike në hapësiren manifeste të nxënësve nga viset rurale .....	36
<b>5.4 DALLIMET NDËRMJET NXËNËSVE TË VISEVE URBANE DHE RURALE .....</b>	<b>37</b>
5.4.1 T–testi ndërmjet nxënësve të viseve urbane dhe rurale në hapësirën antropometrike dhe motorike .....	37
<b>6. VËRTETIMI I HIPOTEZAVE .....</b>	<b>39</b>
<b>7. PËRFUNDIMI .....</b>	<b>40</b>
<b>8. SUMMARY .....</b>	<b>41</b>
<b>9. LITERATURA .....</b>	<b>42</b>
<b>10. PARAQITJA GRAFIKE E REZULTATEVE URBANE DHE RURALE .....</b>	<b>44</b>
10.1 Rezultatet e nxënësve të SHMU “ Rasim Kiqina” Drenas .....	44
10.2 Rezultatet e nxënësve të SHMU “ Shaban Polluzha” Koroticë-Drenas .....	50

## 1.HYRJJE

Nje nder sportet të cilat janë të zhvilluara në vendin tonë është edhe sporti i hendbollit, sport i cili gjendet në mesin e sporteve më atraktive, polistrukturale komplekse, me aksione shumë të shpejta, e cila ka bërë që të jetë një ndër sportet më të njohura në botë.

Në vendin tonë loja e hendbollit është duke u zhvilluar me një ritëm të mirë sikurse në kategorinë e meshkujve ashtu edhe për femra. Poashtu edhe në komunën e Drenasit ky sport është mjaftë aktiv dhe e përfaqëson qytetin tonë në garat kombëtare në hendboll, të organizuara nga Federata e Hendbollit të Kosovës, me ekipin e meshkujve i cili gjendet në Superligën e Kosovës në Hendboll.

Loja e hendbollit praktikohet edhe në sportin shkollorë ku nxënësit nëpërmjet lojës së hendbollit bëjnë gara në nivel shkollorë dhe në nivel komunal.

Gjatë orëve të edukatës fizike dhe sportit , arsimtarët duhet të arrijnë të bëjnë analiza në karakteristikat antropometrike dhe motorike për të bërë një seleksionim për lojën e hendbollit në mënyrë që të masivizojnë sportin e hendbollit edhe qytetin tonë si për meshkuj ashtu edhe për femra.

Për të bërë një punë të tillë duhet hulumtuar edhe në pjesët rurale të komunës së Drenasit sepse talente të tillë mund të ketë edhe atje, ku me një punë sistematike e arsimtarëve të edukatës fizike dhe sportit do të mund të angazhohen edhe jashtë procesit mësimorë për të identifikuar talentet.

Nëpërmjet këtij punimi ne do të mundohemi të vërtetojmë punën e cila bëhet në viset rurale dhe në qytetin e Drenasit me nxënës të moshës 13-14 vjeçare.

## 1.1 Hulumtimet e deritanishme

Për të implementuar këtë punim master ne jemi bazuar në disa nga hulumtimet e realizuara në vendin tonë nga autorët tanë dhe nga disa autorë të huaj të cilët kanë bërë punime të ngjashme në lëminë e sportit të hendbollit e veqanarisht në hapësiren antropometrike dhe motorike, ata janë:

Më (2004) Autori Dr. Afrim Koca në punimin e tij të magjistraturës nga testet e aplikuara dhe metodat e shfrytëzuara në hulumtimin e bërë ka qenë të vëhen në pah ndryshimet ndërmjet katër grupeve në të dy hapësirat si dhe të vërtetohen ndërlidhjet (relacionet) e dimensionëve antropometrike dhe motorike në mes të sportistëve të katër sporteve kolektive (hendbollisteve, basketbollistëve, hendbollisteve dhe volejbollistëve).

Poashtu i njëjti autor Dr. Afrim Koca në vitin (2009), në hulumtimin e tij të doktoraturës në sportin e hendbollit me titull: "Relacionet dhe ndryshimet në hapësiren antropometrike, funksionale dhe aftësive levizore bazike e të levizjeve situacionale ndërmjet hendbollisteve (juniorë) të superligës dhe ligës së parë të kampionatit të kosovës në hendboll" autori në këtë hulumtim ka arritur të vërtetoj relacionet në hapësiren manifeste dhe ka përdorur faktoriale dhe analizen e T-testit.

Prof.dr. Masar Nixha në vitin (1985) Në disertacionin e tij të titulluar "Analiza e karakteristikave trupore dhe aftësive motorike të basketbollistëve të niveleve të ndryshme garuese dhe analiza komparative me volejbollistë dhe hendbollistë", ku si mostër entitetesh ka marrë lojtarët të tri rangjeve, kurse mostra e ndryshoreve ka qenë 11 antropometri dhe 7 motorikë.

Po i njejt autor në vitin (1982) Prof. dr. Masar Nixha nga punimi i tij me titull “Analiza kooperative e karakteristikave trupore dhe aftësive motorike të basketbollistëve të niveleve të ndryshme garuese”. Mostra e etniteteve kanë qenë tri ekipe të para të ligës së dytë të ish federatës së atëhershme dhe tri ekipet e para të ligës së parë të Kosovës në sezonin 1981 / 1982.

Ndërkaq Prof.dr, Enver Gjinolli. (1997), në hulumtimin e tij me titull “Karakteristikat antropometrike të vlefshme për volejball të nxënësit e klasës së pestë të shkollës fillore“ ka bërë hulumtimin duke pasur qëllim thelbësor antropometrinë dhe motoriken me nxënësit me orientim në volejball. Në faktorizimin e hapësirës antropometrike janë izoluar dy dimensione latente antropometrike: në analizën regresive në mostrën e variablave predikore janë përfshirë 18 ndryshore antropometrike, kurse në atë motorike 10.

Një ndër punimet e cila vlenë të marrim si bazë për hulumtime në vitin (2001), autori ka arritur të bëjë vlerësimin e parametrave antropometrik dhe motorik të hendbollistëve të Anamoravës, Dr. Musa Selimi me ç’rast ka përdorur analizën faktoriale dhe iu kanë ekstrahuar tre faktorë latent në hapësirën antropometrike dhe tre faktorë latentë motorik të cilët janë emërtuar si: 1.Faktori longitudinal dhe transversal i skeletit.

2.Faktori i dimensionit cirkular dhe i masës së trupit.

3.Faktori i dimensionit cirkular dhe transversal i gjymtyrë të poshtme.

Ndërsa në hapësirën motorike:

1.Faktori i fleksibilitetit dhe i aftësive të lëvizjeve situacionale me top.

2.Faktori i udhëheqjes së topit në gjysmërreth dhe agjilitetit.

3.Faktori i shpejtësisë së udhëheqjes së topit dhe i forcës eksplozive

Poashtu Prof. Hysen Rakovica në vitin (1998) në hulumtimin në hulumtin e tij të quajtur “Hapësira motorike e fëmijëve të moshës 11 vjeçare dhe faktorizimi i saj”<sup>11</sup>, në mostrën prej 300 nxënësve ka trajtuar aftësitë motorike të tyre përmes 14 testeve. Me analizën faktoriale ka ekstraktuar 4 faktorë latentë të hapësirës motorike:

- 1.Faktori i shpejtësisë dhe i forcës.
- 2.Faktori i forcës statike dhe përsëritëse i këmbëve.
- 3.Faktori i lëvizshmërisë së këmbëve.
- 4.Faktori forcës statike dhe përsëritëse të këmbës.

Autori tjetër nga vendi Prof. Dr. Faik Çitaku në vitin (1981), në hulumtimin e tij me titull “ Struktura latente e precizitetit” të cilin e realizuar me nxënësit e shkollave të mesme të moshës 18 vjeçare në komunën e Lipjanit, të Pejës dhe të Podujevës. Për këtë hulumtim ka pasur gjithsej 32 ndryshore të precizitetit motorik, ndërsa numri i entiteteve ishte 496 nxënës. Qëllimi themelor i këtij hulumtimi ka qenë konstatimi i strukturës primare të precizitetit latent. Në këtë hulumtim është punuar me analizën faktoriale latente të strukturës së precizitetit, me ç’rast janë vërtetuar tre nivele të strukturës latente të precizitetit.

I njëjti autor në vitin (1981) Prof. Dr. Faik Çitaku ky autorë ka bërë hulumtime në hapësirën motorike në segmente të forcës,shpejtësisë dhe precizitetit.Këto hulumtime i ka realizuar me 118 sportistë aktivë(hendbollistë,basketbollistë dhe volejbollistë) të ligës së Kosovës dhe asaj Federative.Qëllimi themelor i këtij hulumtimi ka qenë përcaktimi i strukturës faktoriale të variablave të zbatuara,përcaktimi i ndërlidhjeve faktoriale në hapësirën manifeste dhe latente,varësisht nga tri grupet e sportistëve. Në bazë të analizës së të dhënave janë emërtuar katër faktorë të rëndësishëm:

Faktori i parë është definuar si kombinim i forcës repetitive dhe statike ,  
faktor i dytë është definuar si forcë eksplozive,

faktori i tretë është emërtuar si kombinim i forcës statike në radhë të parë dhe si forcë repetitive në rend të dytë. Është konstatuar se preciziteti nuk është ekstrahuar si faktor. Variablat e aplikuara të hapësirës bazike motorike nuk diferencojnë sportistët në grupe.

Një ndër autorët e huaj i cili vlen të përmendet për hulumtimet e tij është Gabrijelic., M. I cili në vitin (1977), në mostrën etij prej 222 sportistëve kulminantë të rangut federativ, të moshës 18-25 vjeçare, anëtar të kategorisë së sporteve mashkullore, basketboll (54), futboll (52), volejbol (58), hendboll (58), lidhmëria e dimensioneve manifeste latente, të përgjithshme dhe situacionale motorike, kognitive dhe konative me sukses në secilën lojë sportive posaçërisht, atë e ka bërë analizën komparative të lojërave sportive. Janë përdorur 16 teste universale në të gjitha grupet e të testuarve , dhe atë nga tre teste situacionale situacionale për secilën lojë sportive . Aftësitë e basketbollistëve kulminant në krahasim me sportet tjera janë renditur si në vazhdim : Basketbollistët janë superior në forcën eksplozive të këmbëve dhe duarve, kurse më inferior në shpejtësinë e vrapimit. Përveç kësaj të gjitha dimensionet manifestuese të neurotizmit gjeneral të basketbollistëve janë më se paku të shprehura në raport me tri lojërat tjera sportive.



## 2.QËLLIMI I PUNIMIT

Për të bërë vlerësimin e karakteristikave të nxënësve të cilët jetojnë në pjesën rurale të komunës së Drenasit dhe atyre që jetojnë në qytet nëpërmjet lojës së hendbollit do të përdorim disa nga qëllimet për të arritur deri te rezultati.

Qëllim të parë në këtë punim e kemi të bëjmë vërtetimin e hapësirës morfologjike tek nxënësit të cilët do të jenë mostër e këtij punimi, ku do të vërtetohen nëse ekzistojnë dallime ndërmjet atyre.

Qëllim tjetër në këtë punim është gjithashtu edhe vlerësimi i aftësive në hapësirën e motorikes bazike, për nxënësit të cilët jetojnë në viset rurale dhe ata në qytet ku do të vërtetohen dallimet e aftësive të motorikes bazike ndërmjet tyre.

Qëllimi i tretë në këtë studim është i rëndësishëm pasi që mendohet të vërtetohen aftësitë në realizimin e testeve të motorikës specifike për lojën e hendbollit, ku mund të vërtetojm se sa kanë njohuri nxënësit në këtë lojë nga të dy pjesët ku do të bëhet punimi.

## 2.1. HIPOTEZAT THEMELORE

Hipotezat e këtij punimi janë paraqitur me poshtë dhe mendojm se janë të mjaftueshme për këtë punim:

**H1:** Presim që do të fitojmë rezultate themelore statistikore në hapësirën antropometrike, motorike dhe të motorikes specifike tek nxënësit në tërësi.

**H2:** Presim që do të paraqiten ndërlidhje të larta në mes të variablave antropometrike dhe motorikes bazike e specifike tek nxënësit në tërësi.

**H3:** Presim që të paraqiten dallime në mes nxënësve nga viset rurale dhe atyre nga Drenasi në hapësirën antropometrike, motorike dhe motorike specifike

### 3.METODAT E PUNËS

#### 3.1. Mënyra e zbatimit të punimit

Mënyra e zbatimit të këtij studimi do të jetë, duke e marrur mostrën prej 50 nxënës të gjinisë mashkullore te klasës së VIII nga shkolla e mesme e ulët “ Rasim Kiqina” nga qyteti i Drenasit dhe 50 nxënës të klasës së VIII nga pjesët rurale që i takojnë komunës së Drenasit nga shkolla e mesme e ulët “ Sahaban Polluzha ” Fshati Koroticë komuna e Drenasit.

Matjet për këtë studim do të bëhen nëpër shkollat e lartpërmendura, matjet antropometrike do të realizohen në orët e para të ditës, ndërsa matjet e motorikës bazike dhe asaj specifike do të realizohen gjatë orarit të mësimit dhe do të shfrytëzohen poligonet sportive dhe sallat e edukatës fizike. Gjatë matjeve nxënësit do të jenë të uniformuar me veshje sportive në mënyrë që të bëhen matjet më lehtë. Matjet antropometrike do të realizohen nga kolegët e edukimit fizik dhe sportit të cilët kanë realizuar disa herë matje dhe janë të përgatitur për të bërë matje të sakta.

Në këtë punim janë aplikuar katër variabla antropometrike:

**APESHA** – Pesha e trupit

**ALARTESIA** – Lartësia e trupit

**AGJSHDORE**- Gjatësia e shuplakës së dorës

**AGJASHKEM** – Gjatësia e shputës së këmbës

Për vlerësimin e aftësive të motorikes bazike janë këto variabla:

**MKGJATV** – Kërcim së gjati nga vendi

**MKLARTVE** – Kërcim së larti nga vendi

**MKVRAP20** – Vrapim në 20 metra starti i lartë

Ndërsa për vlerësimin e aftësive të motorikes specifike janë këto variabla:

**MGJMEDB** – Hedhja e medicinbollit nga vendi

**MUDHETOP** – Udhëheqja e topit

**MSAKSTS** - Gjuajtjet e topit në saktësi

### 3.1.1. Sistemi i variablave antropometrike

Sistemi i variablave antropometrike për këtë studim janë vlerësuar katër variabla për të cilat mendojm se e plotësojnë kriterin e mjaftueshëm për të hulumtuar këtë fushë duke u bazuar në moshën dhe numrin e entiteteve për këtë studim:

- **Pesha e trupit**

Mjetet për matje: Peshorja antropometrike

Pesha matet me peshorën antropometrike dixhitale apo klasike, e cila na e mundëson saktësinë e matjes prej 0.1 kg. E domosdoshme është që peshorja të vihet në pozitë horizontale dhe në bazament të fortë. I testuari është i zbatuar në veshje sportive, qëndron i qetë, në këmbë, në mes të peshorës. Pasi të qetësohet boshti në pozitën ekuilibruese lexohet rezultati. Leximi i rezultatit bëhet me saktësi 0.1 kg.



Foto 1

- **Lartësia e trupit**

Mjetet për matje: Antropometri i gjatë sipas Martinit

Gjatësia e trupit matet me antropometër që quhet sipas Martinit, nxënësi që matët duhet të jetë i zbathur, në veshje sportive dhe të qëndroj drejt në bazament të fortë horizontal. Koka e tij duhet të jetë në pozitë që skaji i poshtëm i syrit dhe skaji i epërm i zgavrës së jashtme të veshit të jenë në pozitë horizontale (horizontalja e Frankfurtit). Qëndrimi i trupit të nxënësit duhet të jetë i relaksuar dhe i drejtë, shputat e bashkuara, ndërsa matësi qëndron në të majtë të entitetit. Leximi i rezultatit bëhet saktësi 0.1cm.




**Foto 2**

- **Gjatësia e shuplakës së dorës**

Mjetet për matje: kompas rrëshqitës

Gjatësia e shuplakës së dorës matet me kompas rrëshqitës dhe atë në dorën aktive. Majet e Antropometrit vendosen në fund të gishtit të mesëm në majen e gishtit digitus medius deri te vija ndërmjet radiusit dhe ulnës. Leximi i rezultatit bëhet saktësi 0.1cm.



**Foto 3**

- **Gjatësia e shputës së këmbës**

Mjetet për matje: kompas rrëshqitës

Gjatësia e shputës së këmbës matet me kompas rrëshqitës, i maturi qëndron ulur me këmbën e majtë të mledhur që formon këndin e drejtë dhe me shputë të vendosur në dyshe, matësi i vendos krahët e kompasit rrëshqitës në thembër dhe në gishtin më të gjatë të shputës. Leximi i rezultatit bëhet saktësi 0.1cm.




Foto 4



### 3.1.2. Sistemi i variablave të motorikes bazike dhe motorikes specifike

Për të vlerësuar aftësitë e motorikes bazike dhe motorikës specifike për lojën e hendbollit tek nxënësit e përzgjedhur për mostër në këtë punim i kemi përzgjedhur disa teste të motorikes bazike dhe të motorikes specifike siç janë:

- **Kërcimi së gjati nga vendi.**

Mjetet për matje: Shiriti metrik i vendosur në dy anët e vendit për kërcim.

Nxënësi duhet të qëndroj i kthyer me fytyrë nga drejtimi i kërcimit në pozitë drejtëqëndrimi me këmbë të thyera në gjunjë që ia mundëson kërcimin më të mirë. Testi përsëritet tre herë, duke përsëritur kërcimet njërin pas tjetrit. Merret gjatësia më e lartë e arritur nga nxënësi e kërcimit prej vijës shtytëse e deri te gjurmët e shputave (pjesa fundore). Rezultati lexohet me saktësi prej 0.1 cm.



Foto 5

- **Kërcimi së larti nga vendi**

Mjetet për matje: shiriti metrik i vendosur në muri.

Nxënësi i vendosur brinjazi nga muri, së pari e shtrin krahun lartë në të gjitha nyjet. Matet lartësia nga dyshemeja deri të gishti i mesëm, që shënohet me centimetra. Nxënësi nga qëndrimi vertikal i kthyer nga shiriti centimetrik-brinjazi, kërcen me të dy këmbët në lartësi dhe e prek shiritin në pikën më të lartë të mundshme me njërin dorë. Pas shënimit të matjes së lartësisë pa kërcim në shtrirjen e krahut dhe pas kërcimit nga vendi, e gjejmë lartësinë e shkëputjes nga vendi. Testi përsëritet tre herë, duke përsëritur kërcimet njërin pas tjetrit. Merret gjatësia më e lartë e arritur nga nxënësi. Rezultati lexohet me saktësi prej 0.1 cm.




Foto 6

- **Vrapimi në 20 metra starti i lartë**

Mjetet për matje: Kronometri, pipi sinjalizues dhe rekuizita për shënimin e startit.

Nxënësi duhet të startoj n nga posita e lartë dhe ka për detyrë që distancën prej 20m ta kaloj me shpejtësi maksimale dhe kohë sa më të shkurt të mundshme.Koha e kalimit të distancës duhet të matet me saktësi 1/10 e sekondës. Testi realizohet në poligon të hapur apo në sallë të edukatës fizike në sipërfaqe të rrafshtë. Rezultati lexohet me saktësi prej 0.1sec.



**Foto 7**

- **Gjuajtja e topit të medicinbollit nga vendi**

Mjetet për matje: Shiriti metrik i gjatë, topi i medicinbollit 2kg

Nxënësi me tre hapa lëvizje pa shkëputje nga vija e gjuajtjes, gjuan topin e medicinbollit të peshë 2kg në gjatësi aq sa mundet. Gjatësia matet rënia e topit të medicinbollit në pikën e parë pas gjuajtjes me saktësi. Testi mund të përsëritet 2 herë. Matësi e kontrollon saktësinë e realizimit të lëvizjeve në teknikën përkatëse. Rezultati lexohet me saktësi prej 0.1 cm.




Foto 7

Për të vlerësuar aftësitë e nxënësve në lojën e hendbollit janë përzgjedhur disa nga testet e motorikes specifike me ç'rast ishte edhe qëllimi kryesorë në këtë studim pasi që mund të bëjmë vlerësimin e zbatimit të lojës së hendbollit nëpër shkolla, nxënësit do të testohen në 3 teste të motorikes specifike për hendboll ato janë:

- **Udhëheqja e topit të hendbollit**

Mjetet për matje: Topi i hendbollit, kronometri,

Nisja bëhet nga vija e 6 metërshit deri te vija e 6 metërshit të fushës tjetër.

Nxënësi ka për detyrë që nga vija e nisjes të vrapoj sa më shpejt që është e mundur duke udhëhequr topin kah vija tjetër e 6 metërshit. Ky test përsëritet dy here pa ndërprerë pasi që këtu testohet: shpejtësia e udhëheqjes me top, niveli teknik i zbatimit të udhëheqjes dhe qëndrueshmëria situacionale. Rezultati lexohet me saktësi prej 0.1sec.



**Foto 8**

- **Saktësia e goditjes se shenjës**

Mjetet për matje: Topi i hendbollit, ngjitës, tablo

Nxënësi vendoset në vijën e 7 metërshit i kthyer në pozite të drejte me portën. I ka të vendosur 5 topa të hendbollit afër vete dhe ai duhet në mënyrë precize të gjuaj 5 herë në drejtim të shenjës së vendosur në këndin e portës. Ndhmësi i jep topin në dorë, nxënësi mund të bëj levizje nga vendi për 180 shkallë dhe të gjuaj në portë, ku në këndin e djathtë të sipërm të portës është e vendosur një tablo me dimensione 50x50 cm. Në fletëtestim shënohen vetëm goditjet e sakta në cak.



Foto 9

#### 4. Metodatat dhe përpunimi i rezultateve

Për të arritur qëllimet e parashtruara më lartë si dhe për të vërtetuar hipotezat e parashtruara, kemi përdorur programin statistikore SPSS 23 për windows dhe do të aplikojmë metodatat e nevojshme për të interpretuar rezultatet dhe shpresojmë të na e mundësojnë sigurimin e informatave të mjaftueshme për këtë punim master.

- Janë llogaritur parametrat themelorë statistikorë për të dy grupet e sistemit të variablave për secilën variabël, si dhe masat e asimetrisë.
- Gjithashtu janë llogaritur raportet e korrelacioneve ndërmjet variablave në hapësirën manifeste, si dhe kroskorrelacionet ndërmjet sistemit të variablave, për të dy hapësirat.
- Për të vërtetuar dallimet ndërmjet dy grupeve të marrur për mostër në hapësirën antropometrike, motorikes bazike dhe motorikes specifike është aplikuar analiza e T – testit

## 5. REZULTATET DHE DISKUTIMET

### 5.1. Parametrat themelorë statistikorë të matjeve antropometrike të nxënësve nga viset urbane dhe rurale të komunës së Drenasit

#### 5.1.1. Rezultatet e parametrave themelor statistikor të matjeve antropometrike, urbane


**Tabela 1** Rezultatet e parametrave themelore statistikore të variablave antropometrike urbane

Variablat	N	Minim	Maxim	Mean	Std. Dev.	Skewnes	Kurtos.
APESHA	40	35,00	82,00	55,125	12,649	,273	-,612
ALARTESIA	40	148,00	184,00	167,750	9,286	-,420	-,628
AGJSHDORE	40	14,03	20,03	17,134	1,355	-,329	-,194
AGJASHKEM	40	20,03	28,02	23,839	1,651	,213	,237

Në tabelën 1 janë paraqitur rezultatet e parametrave themelore statistikore antropometrike të nxënësve nga Shkolla e mesme e ulët “Rasim Kiqina” mostër e marrur nga pjesa urbane e qytetit të Drenasit. Në këtë punim master janë aplikuar katër variabla të hapësirës antropometrike ato janë: Pesha e trupi ( APESHA), Lartësia e trupit (ALARTESIA) Gjatësia e shuplakës së dorës (AGJSHDORE) dhe Gjatësia e shuplakës së këmbës (AGJASHKEM). Për të analizuara rezultatet e matjeve të nxënësve nga viset urbane në këtë rast nxënësit e qytetit të Drenasit ne i kemi përdorur analizën deskriptive me elementet themelore statistikore siç janë : Numri i nxënësve (N), Rezultati minimal (minim), Rezultati maksimal (maxim.) Mesi aritmetikor (mean) , Devijimi standard (std. dev), sikurse edhe masat e asimetrisë (skevnes dhe kurtos).



Rezultateve të fituara në tabelën 1 të paraqitur më lartë mund të vërejmë se vlerat e mesit aritmetikor të katër variablave janë paraqitur nga vlerat e bazuara në rezultatet minimale dhe maksimale të cilat janë reflektuar nga devijimi standard, e ku vlera më të larta të devijimit kanë paraqitur variabla e peshës së trupit në vlerë 12.649 dhe lartësia e trupit në vlerë 9.28, ndërsa rezultatet tjera janë paraqitur në suaza të normales vlera të cilat i arsyetojnë edhe vlerat e masave asimetrike të cilat tregojnë për vlera të shpërndara në mënyrë normale. Për të vërejtur në mënyrë grafike shtrirjen e rezultateve ne më poshtë e kemi paraqitur edhe grafikonin numër 1 ku mund të vërehet shpërndarja e rezultateve të nxënësve nga viset urbane.



**Grafikoni 1**


### 5.1.2. Rezultatet e parametrave themelor statistikor të variablave, motorike bazike e specifike urbane

**Tabela 2 Parametrat themelor statistikor të variablave motorike bazike e specifike urbane**

Variablat	N	Minim	Maxim	Mean	Std. Dev.	Skeënes	Kurtos.
MKGJATVE	40	120,00	193,00	162,500	19,372	-,494	-,577
MKLARTVE	40	13,00	61,00	39,475	10,977	-,128	-,266
MKVRAP20	40	3,33	4,97	4,285	,364	-,331	,263
MGJMEDB	40	5,01	12,55	8,296	1,561	,491	,476
MUDHETOP	40	11,94	17,95	14,623	1,730	,053	-1,060
MSAKSTS	40	0,00	4,00	1,600	1,127	,528	-,281

Rezultatet e parametrave themelore statistikore motorike të nxënësve nga Shkolla e mesme e ulët “Rasim Kiqina” mostër e marrur nga pjesa urbane e qytetit të Drenasit janë paraqitur në tabelën numër 2. Në hapësirën e motorikes bazike dhe asaj specifike janë aplikuar gjashtë variabla ato janë: Kërcimi së gjati nga vendi (MKGJATVE), Kërcim së larti nga vendi (MKLARTVE), Vrapim 20 metra (MKVRAP20) gjuajtja e medicinbollit (MGJMEDB), Udhëheqja e topit (MUDHETOP) dhe testi i precizitetit (MSAKSTS). Rezultatet e matjeve të nxënësve nga viset urbane në këtë rast nxënësit e qytetit të Drenasit ne i kemi analizuar nëpërmjet analizës deskriptive me elementet themelore statistikore siç janë: Numri i nxënësve (N), Rezultati minimal (minim), Rezultati maksimal (maxim.) Mesi aritmetikor (mean), Devijimi standard (std. dev), sikurse edhe masat e asimetrisë (skewnes dhe kurtos).

Rezultatet e fituara nga analiza deskriptive janë paraqitur në tabelën 2 ku mund të vërehet se vlerat e mesit aritmetikor të variablave në hapësirën motorike janë paraqitur nga vlerat e bazuara në rezultatet minimale dhe maksimale të cilat janë reflektuar nga devijimi standard, e ku vlera më të larta të devijimit kanë paraqitur variabla e Kërcimi së gjati nga vendi në vlerë 19.372 ), Kërcim së larti nga vendi në vlerë 10.977, ndërsa rezultatet tjera janë paraqitur në suaza të normales me vlera të cilat i arsyetojnë edhe masat asimetrike të cilat tregojnë për vlera të shpërndara në mënyrë normale. Për të vërejtur në mënyrë grafike shtrirjen e rezultateve në hapësirën e motorikes bazike dhe specifike ne më poshtë e kemi paraqitur edhe grafikunin numër 2 ku mund të vërehet shpërndarja e rezultateve të nxënësve nga viset urbane.



**Grafikoni 2**


### 5.1.3. Rezultatet e parametrave themelor statistikor të variablave antropometrike të viseve rurale

**Tabela 3. Rezultatet e parametrave themelore statistikore të variablave antropometrike rurale**

Variablat	N	Minim	Maxim	Mean	Std. Dev.	Skeënes	Kurtos.
APESHA	40	35,70	83,40	51,787	10,726	1,002	1,744
ALARTESIA	40	148,00	183,00	168,375	9,325	-,443	-,619
AGJSHDORE	40	13,16	19,80	17,199	1,483	-,641	,331
AGJASHKEM	40	18,10	26,80	23,573	2,090	-,833	,354

Në tabelën 3 janë paraqitur rezultatet e parametrave themelore statistikore antropometrike të nxënësve nga Shkolla e mesme e ulët “Shaban Polluzha” Koroticë mostër e marrur nga pjesa rurale e Komunës së Drenasit. Edhe tek kjo mostër është aplikuar me katër variabla të hapësirës antropometrike ato janë: Pesha e trupit (APESHA), Lartësia e trupit (ALARTESIA) Gjatësia e shuplakës së dorës (AGJSHDORE) dhe Gjatësia e shuplakës së këmbës (AGJASHKEM). Për të analizuar rezultatet e matjeve të nxënësve nga viset rurale në këtë rast nxënësit e fshatit Koroticë ne e kemi përdorur analizën deskriptive me elementet themelore statistikore siç janë : Numri i nxënësve (N), Rezultati minimal (minim), Rezultati maksimal (maxim.) Mesi aritmetikor (mean) , Devijimi standard (std. dev), sikurse edhe masat e asimetrisë (skewnes dhe kurtos).

Nga rezultatet e fituara në tabelën 3 të paraqitur më lartë mund të vërejmë se vlerat e mesit aritmetikore të hapësirës antropometrike janë paraqitur në suaza të normales nga rezultatet minimale dhe maksimale të cilat janë reflektuar nga devijimi standard, e ku vlera më të larta të devijimit kanë paraqitur variabla e peshës së trupit në vlerë 10.726 dhe lartësia e trupit në vlerë 9.325, ndërsa rezultatet tjera janë paraqitur vlera të cilat i arsyetojnë edhe vlerat e masave asimetrike të cilat tregojnë për vlera të shpërndara në mënyrë normale. Për të vërejtur në mënyrë grafike shtrirjen e këtyre rezultateve ne më poshtë e kemi paraqitur edhe grafikoni numër 3 ku mund të vërehet shpërndarja e rezultateve të nxënësve nga viset rurale të komunës së Drenasit.



**Grafikoni 3**


#### 5.1.4. Rezultatet e parametrave themelor statistikor të variablave, motorike bazike e specifike rurale

**Tab 4. Parametrat themelor statistikor të variablave motorike bazike e specifike rurale**

Variablat	N	Minim	Maxim	Mean	Std. Dev.	Skeënes	Kurtos.
MKGJATVE	40	124,00	202,00	167,725	16,507	-,126	,356
MKLARTVE	40	21,00	68,00	43,725	10,751	-,333	-,145
MKVRAP20	40	3,40	4,87	4,242	,336	,010	-,091
MGJMEDB	40	4,32	13,80	8,115	1,717	,817	1,944
MUDHETOP	40	10,15	17,10	13,667	1,569	-,094	-,338
MSAKSTS	40	0,00	5,00	2,275	1,339	,207	-,266

Rezultatet e parametrave themelore statistikore motorik të nxënësve nga Shkolla e mesme e ulët “Shaban Polluzha” nga Korotica mostër e marrur nga pjesa rurale e Komunës së Drenasit janë paraqitur në tabelën numër 4. Në hapësirën e motorikes bazike dhe asaj specifike janë aplikuar gjashtë variabla ato janë: Kërcimi së gjati nga vendi ( MKGJATVE), Kërcim së larti nga vendi (MKLARTVE), Vrapim 20 metra (MKVRAP20) gjuajtja e medicinbollit (MGJMEDB), Udhëheqja e topit (MUDHETOP) dhe testi i precizitetit (MSAKSTS). Rezultatet e matjeve të nxënësve nga viset rurale në këtë rast nxënësit e fshatit Koroticë ne i kemi analizuar nëpërmjet analizës deskriptive me elementet themelore statistikore siç janë: Numri i nxënësve (N), Rezultati minimal (minim), Rezultati maksimal (maxim.) Mesi aritmetikor (mean), Devijimi standard (std. dev), sikurse edhe masat e asimetrisë (skewnes dhe kurtos).

Rezultatet e fituara nga analiza deskriptive janë paraqitur në tabelën 4 ku mund të vërehet se vlerat e mesit aritmetikor të variablave në hapësirën motorike janë paraqitur nga vlerat e bazuara në rezultatet minimale dhe maksimale të cilat janë reflektuar nga devijimi standard, e ku vlera më të larta të devijimit kanë paraqitur variabla e Kërcimi së gjati nga vendi në vlerë 16.507 dhe testi i kërcimit së larti nga vendi në vlerë 10.751, ndërsa rezultatet tjera janë paraqitur në suaza të normales me vlera të cilat i arsyetojnë edhe masat asimetrike të cilat tregojnë për vlera të shpërndara në mënyrë normale. Për të vërejtur në mënyrë grafike shtrirjen e rezultateve në hapësirën e motorikes bazike dhe specifike ne më poshtë e kemi paraqitur edhe grafikunin numër 4 ku mund të vërehet shpërndarja e rezultateve të nxënësve nga viset rurale të komunës së Drenasit.



**Grafikoni 4**

## 5.2. Korrelacionet ndërmjet rezultateve të nxënësve nga viset urbane dhe rurale të komunës së Drenasit

### 5.2.1. Koeficientet e korrelacioneve në hapësirën antropometrike urbane

Koeficientet e korrelacioneve në hapësirën antropometrike të nxënësve nga viset urbane të komunës së Drenasit janë paraqitur në tabelën 5. Duke analizuar rezultatet korrelacioneve ndërmjet variablave në hapësirën antropometrike janë paraqitur vlerat e koeficienteve të cilët tregojnë për lidhjet ndërmjet tyre tek mostra e nxënësve urban. Në këtë tabelë mund të vërejmë se rezultatet në amëzën e korrelacioneve ndërmjet variablave antropometrike janë paraqitur në tërësi kanë dhenë vlera të larta të korrelacioneve. Ndërsa për t'i analizuar variablat veç e veç ato tregojnë vlera shumë të larta korelative, siç janë: variabla e peshës së trupit me variablat ALARTESIA, AGJSHDORE dhe , AGJSHKEM me vlera prej : .581\*\* deri në .812 \*\*. Edhe variablat e tjera kanë treguar korrelacione me vlera shumë të larta pothuajse më të gjitha variablat e tjera por vlen të theksohet variabla AGJSHKEM me vlerë prej .634\*\* e deri .696\*\*.

**Tabela 5. Koeficientët e korrelacioneve të variablave antropometrike urbane**

Variabla	APESHA	ALARTESIA	AGJSHDORE	AGJASHKEM
APESHA	1			
ALARTESIA	,812**	1		
AGJSHDORE	,581**	,791**	1	
AGJASHKEM	,634**	,693**	,696**	1



### 5.2.2 Koeficientet e korrelacioneve të variablave, motorike bazike e specifike urbane

Korrelacionee në hapësirën e motorikes bazike dhe asaj specifike të nxënësve nga viset urbane të komunës së Drenasit janë paraqitur në tabelën 6. Në tabelën e paraqitur më poshtë dhe duke analizuar rezultatet korrelacioneve ndërmjet variablave në hapësirën e motorikes bazike dhe specifike janë paraqitur vlerat e koeficienteve të cilët tregojnë për lidhjet ndërmjet tyre tek mostra e nxënësve urban. Në këtë tabelë mund të vërejmë se rezultatet në amëzën e korrelacioneve ndërmjet variablave motorike disa prej tyre kanë dhenë vlera të larta të korrelacioneve e disa të tjera më pak. Për t'i analizuar variablat veç e veç ato të cilat tregojnë vlera të larta korelative, janë: variabla e kërcimit së gjati nga vendi me variablat MKLARTVE, MKVRAP20 dhe , MGJMEDB me vlera prej :  $-.411^{**}$  deri në  $.610^{**}$ . Në përgjithësi variablat e testit të forcës eksplozive kanë treguar korrelacione me vlera më të larta ndërsa me testin e precizitetit nuk kanë treguar korrelacione me vlera të larta.

**Tabela 6. Koeficientët e korrelacioneve të variablave motorike bazike e specifike urbane**

Variablat	MKGJATVE	MKLARTVE	MKVRAP20	MGJMEDB	MUDHETOP	MSAKSTS
MKGJATVE	1					
MKLARTVE	,610 <sup>**</sup>	1				
MKVRAP20	-,411 <sup>**</sup>	-,311	1			
MGJMEDB	,596 <sup>**</sup>	,541 <sup>**</sup>	-,392 <sup>*</sup>	1		
MUDHETOP	-,318 <sup>*</sup>	-,384 <sup>*</sup>	,523 <sup>**</sup>	-,454 <sup>**</sup>	1	
MSAKSTS	-,126	-,100	,217	-,202	,000	1

### 5.2.3 Koeficientet e korrelacioneve në hapësirën antropometrike rurale

Koeficientet e korrelacioneve në hapësirën antropometrike të nxënësve nga viset rurale të komunës së Drenasit janë paraqitur në tabelën 7. Duke analizuar rezultatet korrelacioneve ndërmjet variablave në hapësirën antropometrike janë paraqitur vlerat e koeficienteve të cilët tregojnë për lidhjet ndërmjet tyre tek mostra e nxënësve nga viset rurale. Në këtë tabelë mund të vërejmë se rezultatet në amëzën e korrelacioneve ndërmjet variablave antropometrike në tërësi kanë dhënë vlera të larta të korrelacioneve. Ndërsa për t'i analizuar variablat veç e veç, ato tregojnë vlera shumë të larta korelative, siç janë: variabla e peshës së trupit me variablat ALARTESIA, AGJSHDORE dhe , AGJSHKEM me vlera prej : .356\* deri në .602 \*\*. Edhe variablat e tjera kanë treguar korrelacione me vlera shumë të larta pothuajse më të gjitha variablat e tjera por vlenë të theksohet se variabla AGJSHKEM ka treguar rezultate të larta në vlerë prej .356\* e deri .661\*\*, me të gjitha variablat.

**Tabela 7. Koeficientet e korrelacioneve të variablave antropometrike rurale**

Variablat	APESHA	ALARTESIA	AGJSHDORE	AGJASHKEM
APESHA	1			
ALARTESIA	,602**	1		
AGJSHDORE	,556**	,761**	1	
AGJASHKEM	,356*	,522**	,661**	1

#### 5.2.4. Koeficientët e korrelacioneve të variablave, motorike bazike e specifike rurale

Në tabelën 8 janë paraqitur korrelacionet në hapësirën e motorikes bazike dhe asaj specifike të nxënësve nga viset rurale të komunës së Drenasit. Duke analizuar tabelën e paraqitur më poshtë dhe rezultatet korrelacioneve ndërmjet variablave në hapësirën e motorikes bazike dhe specifike janë paraqitur vlerat e koeficienteve të cilët tregojnë për lidhjet ndërmjet tyre tek mostra e nxënësve nga viset rurale. Në këtë tabelë mund të vërejmë se rezultatet në amëzën e korrelacioneve ndërmjet variablave motorike disa prej tyre kanë dhenë vlera të larta të korrelacioneve e disa të tjera më të dobëta. Për t'i analizuar variablat veç e veç ato të cilat tregojnë vlera të larta korelative, janë: variabla e kërcimit së gjati nga vendi me variablat MKLARTVE, MKVRAP20 dhe , MGJMEDB me vlera prej : .316\* deri në .625\*\*. Edhe tek rezultatet e viseve rurale në përgjithësi variablat e testit të forcës eksplozive kanë treguar korrelacione me vlera më të larta ndërmjet veti ndërsa me testin e precizitetit nuk kanë treguar korrelacione me vlera të larta.

**Tabela 8. Koeficientët e korrelacioneve të variablave motorike bazike e specifike rurale**

Variablat	MKGJATVE	MKLARTVE	MKVRAP20	MGJMEDB	MUDHETOP	MSAKSTS
MKGJATVE	1					
MKLARTVE	,316*	1				
MKVRAP20	-,477**	-,108	1			
MGJMEDB	,625**	,211	-,433**	1		
MUDHETOP	-,225	-,200	,213	-,266	1	
MSAKSTS	,148	,322*	-,226	,237	-,186	1

### 5.3. KROSKORELACIONET NË MES TË VARIABLAVE ANTROPOMETRIKE DHE MOTORIKE

#### 5.3.1. Kroskorelacionet ndërmjet variablave antropometrike dhe motorike në hapësirën manifeste të nxënësve nga viset urbane

Kroskorrelacionet ndërmjet variablave të hapësirës antropometrike dhe variablave të hapësirës motorike bazike dhe specifike të nxënësve nga viset urbane të komunës së Drenasit janë paraqitur në tabelën 9. Duke analizuar amëzen e kroskorrelacioneve ndërmjet hapësirës antropometrike dhe motorike, vlerat e koeficienteve tregojnë për ndërlidhje të disa nga variablat tek mostra e nxënësve urban. Në këtë tabelë mund të vërejmë se rezultatet në amëzën e kroskorrelacioneve ndërmjet variablave antropometrike dhe motorike janë paraqitur ndërmjet variablave të faktorit longitudinal me atë të forcës eksplozive dhe më pak me ato të precizitetit. Duke i analizuar variablat veç e veç disa nga ato tregojnë vlera të larta kroskorelative, siç janë: variabla e lartësisë së trupit me variablat MKGJATVE, MKLARTVE dhe MGJMEDB me vlera prej : .319\* deri në .426 \*\*. Edhe variabla gajtësisë së dorës ka treguar kroskorrelacione me vlera shumë të larta me të njëjtat variabla MKGJATVE, MKLARTVE dhe MGJMEDB me vlera prej : .413\*\* deri në .541 \*\*, ndërsa variablat të tjera nuk kanë treguar ndërlidhje të larta kroskorelative.

**Tabela Nr:9 Amëza e kroskorelacioneve ndërmjet hapësirës antropometrike dhe motorike urbane**

Variablat	APESHA	ALARTESIA	AGJSHDORE	AGJASHKEM
MKGJATVE	,066	,319*	,413**	,244
MKLARTVE	,160	,494**	,502**	,198
MKVRAP20	,277	,154	,056	,209
MGJMEDB	,288	,426**	,541**	,378*
MUDHETOP	,264	,073	-,098	,002
MSAKSTS	,007	-,105	-,041	,012

### 5.3.2 Kroskorelacionet ndërmjet variablave antropometrike dhe motorike në hapësiren manifeste të nxënësve nga viset rurale

Kroskorrelacionet ndërmjet variablave të hapësires antropometrike dhe variablave të hapësires motorike bazike dhe specifike të nxënësve nga viset rurale të komunës së Drenasit janë paraqitur në tabelën 10. Duke analizuar amëzen e kroskorrelacioneve ndërmjet hapësirës antropometrike dhe motorike, vlerat e koeficienteve tregojnë për ndërlidhje të disa nga variablat tek mostra e nxënësve të viseve rurale. Poashtu edhe në këtë tabelë mund të vërejmë se rezultatet në amëzën e kroskorrelacioneve ndërmjet variablave antropometrike dhe motorike janë paraqitur ndërmjet variablave të faktorit longitudinal me atë të forcës eksplozive dhe më pak me ato të precizitetit. Duke i analizuar variablat veç e veç disa nga ato tregojnë vlera të larta kroskorelative, siç janë: variabla e lartësisë së trupit me variablat MKGJATVE, dhe MGJMEDB me vlera prej : .599\* deri në .613 \*\*. Edhe variabla gajtësisë së dorës ka treguar kroskorrelacione me vlera shumë të larta me të njëjtat variabla MKGJATVE, MKLARTVE dhe MGJMEDB me vlera prej : .324\* deri në .669 \*\*, ndërsa vlenë të theksohet se variablat nga hapësira motorike që ka treguar ndërlidhje është gjuajtja e medicinbollit me të gjitha variablata antropometrike në vlerë prej .288\* deri në .669\*\*.

**Tabela Nr:10 Amëza e kroskorelacioneve ndërmjet hapësirës antropometrike dhe motorike rurale**

Variablat	APESHA	ALARTESIA	AGJSHDORE	AGJASHKEM
MKGJATVE	,154	,599**	,555**	,261
MKLARTVE	,077	,222	,324*	,288*
MKVRAP20	-,086	-,168	-,112	,164
MGJMEDB	,632**	,613**	,669**	,289
MUDHETOP	,048	-,107	,152	,090
MSAKSTS	-,004	,096	,122	,062

## 5.4. DALLIMET NDËRMJET NXËNËSVE TË VISEVE URBANE DHE RURALE

### 5.4.1 T-testi ndërmjet nxënësve të viseve urbane dhe rurale në hapësirën antropometrike dhe motorike

Për të vërtetuar dallimet në mes të dy grupeve e në këtë rast ndërmjet nxënësve të viseve urbane dhe viseve rurale të komunës së Drenasit kemi përdorur analizën e T-testit për grupe të pavarura.

Duke e analizuar tabelën 11 ku janë paraqitur rezultatet në hapësirën antropometrike ndërmjet grupit të nxënësve nga viset urbane të shkollës së mesme të ulët “Rasim Kiqina” nga qyteti i Drenasit dhe ata nga viset rurale shkollës së mesme të ulët “Shaban Polluzha” fshati Koroticë komuna e Drenasit, rezultatet tregojnë se nxënësit nuk kanë dallime të vlefshme statistikore në hapësirën antropometrike dhe kanë treguar se janë afërsisht të njëjtë në rritje dhe në zhvillim.

**Tabela 11 Dallimet ndërmjet grupit të nxënësve nga viset urbane dhe rurale në hapësirën Antropometrike**

Variablat	Entitetet	N	Mean	Std. Deviation	Sig. (2-tailed)
APESHA	urbane	40	55,1250	12,64949	,207
	rurale	40	51,7875	10,72697	
ALARTESIA	urbane	40	167,7500	9,28674	,765
	rurale	40	168,3750	9,32515	
AGJSHDORE	urbane	40	17,1348	1,35572	,840
	rurale	40	17,1990	1,48318	
AGJASHKEM	urbane	40	23,8398	1,65112	,530
	rurale	40	23,5738	2,09045	

Ndërsa duke e analizuar tabelën 12 me ç'rast janë paraqitur rezultatet në hapësirën e motorikes bazike dhe asaj specifike ndërmjet grupit të nxënësve nga viset urbane të shkollës së mesme të ulët “Rasim Kiqina “ nga qyteti i Drenasit dhe ata nga viset rurale shkollës së mesme të ulët “Shaban Polluzha” fshati Koroticë komuna e Drenasit, rezultatet tregojnë se nxënësit nuk kanë dallime të vlefshme statistikore në hapësirën e motorikes bazike dhe kanë treguar se janë afërsisht të njëjtë në realizimin e testeve të motorikes bazike, por ndryshime vjen tek testet e motorikes specifike dhe ato janë në favor të nxënësve të shkollës së mesme të ulët “Shaban Polluzha” nga viset rurale të komunës së Drenasit dhe testi i udhëheqjes së topit është realizuar më shpejt nga nxënësit e viseve rurale me vlefshmëri  $p < 0.012$ , gjithashtu edhe testi i precizitetit të gjuajtjes së topit me saktësi është në favor të nxënësve nga viset rurale me vlefshmëri  $p < 0.017$ .

**Tabela 12 Dallimet ndërmjet grupit të nxënësve nga viset urbane dhe rurale në hapësirën e motorikes bazike dhe specifike**

Variablat	Entitetet	N	Mean	Std. Deviation	Sig. (2-tailed)
MKGJATVE	urbane	40	162,5000	19,37220	,198
	rurale	40	167,7250	16,50794	
MKLARTVE	urbane	40	39,4750	10,97780	,084
	rurale	40	43,7250	10,75124	
MKVRAP20	urbane	40	4,2855	,36408	,583
	rurale	40	4,2423	,33650	
MGJMEDB	urbane	40	8,2968	1,56104	,623
	rurale	40	8,1158	1,71759	
MUDHETOP	urbane	40	14,6235	1,73021	<b>,012</b>
	rurale	40	13,6678	1,56966	
MSAKSTS	urbane	40	1,6000	1,12774	<b>,017</b>
	rurale	40	2,2750	1,33949	

## 6. VËRTETIMI I HIPOTEZAVE

Hipotezat e këtij punimi të paraqitura me lartë duke u bazuar në qëllimin e këtij punimi kanë qenë të mjaftueshme për këtë punim dhe ato janë realizuar në këtë mënyrë si vijon:

Duke analizuar hipotezën e parë që është supozuar se ne do të fitojmë rezultate themelore statistikore në hapësirën antropometrike, motorike dhe të motorikes specifike tek nxënësit në tërësi, rezultatet e arritura tregojnë për specifikat e të gjithë nxënësve të trajtuar në këtë punim, dhe se kjo hipotezë është realizuar në tërësi.

Gjithashtu hipoteza e dytë ka supozuar se do të paraqiten ndërlidhje të larta në mes të variablave antropometrike dhe motorikes bazike e specifike tek nxënësit në tërësi, edhe kjo hipotezë është plotësuar pothuajse pjesërisht me ndërlidhje të vlefshme korelative tek disa varibla ndërmjet tyre ndërsa tek disa më dobët.

Ndërsa qëllimi kryesor i këtij punimi ishte që të vërtetohen dallimet në mes nxënësve nga viset rurale dhe atyre nga Drenasi në hapësirën antropometrike, motorike dhe motorikes specifike, edhe kjo hipotezë është vërtetuar pjesërisht sepse dallime të vlefshme ndërmjet këtyr dy entiteteve janë paraqitur vetëm në pjesën e motorikes specifike në dy variabla.



## 7. PËRFUNDIMI

Mënyra e zbatimit të këtij punimi si dhe qëllimeve të parashtruara më lartë në këtë punim e cila në fokus ka pasur vërtetimin e dallimeve të nxënësve të cilët mësojnë në viset rurale të komunës së Drenasit dhe atyre të cilët mësojnë në qytetin e Drenasit. Gjithashtu kemi arritur të bëjmë vlerësimin e strukturës antropometrike të nxënësve të gjithë entiteteve si dhe vlerësimin e aftësive dhe realizimin e elementeve në motoriken bazike dhe motoriken specifike për lojën e hendbollit.

Në bazë të punës së realizuar gjatë këtij punimi mund të themi se vlera teorike e këtij punimi mund të jetë në funksion vlerësimit të parametrave antropometrik të nxënësve, aftësive të motorikes bazike dhe të motorikes specifike e cila do të shërbejë poashtu për të vlerësuar nivelin e sportit shkollorë nëpër shkolla në përgjithësi dhe zhvillimi i lojës së hendbollit në veçanti për komunën e Drenasit posaçërisht për dy shkollat ku është bërë punimi. Ndërsa vlera praktike e këtij studimi mund të jetë që rezultatet e fituara mund të tregojnë saktë për nivelin e praktikës për lojën e hendbollit në shkollat e mesme të ulëta në viset rurale të komunës së Drenasit dhe nxënësve të qytetit të Drenasit. Një ndër vlerat e shtuara të këtij punimi i cili do të mund të shërbej si model për programimin e ushtrimeve specifike në sportin e hendbollit me nxënës, dhe arritjes së rezultateve ë nivel komunal dhe Republikan ne garat e sportit shkollorë në Kosovë

Në bazë të rezultateve të arritura në këtë punim, mund të arrijmë të bëjmë një vlerësim në hap për zbulimin e talenteve në mesin e nxënësve për lojën e hendbollit dhe shkathtësive të tyre tekniko-specifike. Loja e hendbollit në komunën e Drenasit mund të avancohet edhe më tutje duke marrë pjesë në organizimin e sportit të hendbollit në garat shkollore sepse aty nxënësit mund ti shprehin aftësitë e tyre. Një rezultat i tillë mund të arrihet atëherë kur mësimmshënësit e Edukimit Fizik dhe Sportit do të arrijnë të zbatojnë lojën e hendbollit si një ndër sportet me prioritet.



**Foto 10**

## 8. SUMMRY

In our country handball is very developed as a sports and is considered to be as one of the most attractive, polystructural, complex with very quick actions which help in making the most famous sports in the world. In our country, handball is being developed quite well, regarding the male and female categories.

In addition this sport is very active in the municipality of Drenas by representing our city in the national handball competition, organized by the Handball Federation of Kosova.

To prove that handball is also active in the rural areas, we have conducted a research based on the intentions mentioned above. In this research we tried to find the distinction between students who learn in the rural areas of Drenas and those who attend their lessons in the city of Drenas in the handball game. Through this research we were able to make the evaluation of students' anthropometric structure in the rural and urban areas as well as the evaluation of motor and basic skills and in the specific motoric variables for the handball game.

Based on the results that we have taken from this research we can conclude that a step was made in order to evaluate and find new talents for handball game as well as find their technical-specific skills, regardless whether they are from rural or urban places since there aren't huge differences between them.



## 9. LITERATURA



- 1.Koca, A. (2009) Relacionet dhe ndryshimet në hapësiren antropometrike unksionale dhe aftësive levizore bazike e të levizjeve specifike ndermjet hendbollistëve (juniorë) të superligës dhe ligës së parë të kampionatit të Kosovës në hendboll. Disertacion doktore, Fakulteti i Kulturës Fizike, Prishtinë, Kosovë.
- 2.Çitaku,F.(1981).Hulumtim në hapësiren motorike në segmentë të forcës, të shpejtësisë dhe të precizitetit, i ka realizuar me 118-sportistë aktiv (hendbollistë,basketbollistë dhe volejbollistë) të Ligës së Kosovës dhe të asaj federative\*.Elan, Prishtinë.
- 3.Selimi, M. (2001). Punim Magjistrature Fakulteti i Kulturës Fizike, Prishtinë, Kosovë.
- 4.Nixha,M.(1985), “Analiza e karakteristikave trupore dhe aftësive motorike të niveleve të ndryshme të garave dhe analiza komparative me volejbollistë dhe hendbollistë”.Disertacion doktore,Beograd.
- 5.Rakovica,H.(1997). “ Relacionet në mes të rezultatit kërcim së larti dhe dimensioneve morfologjike dhe motorike”. Disertacion doktore,Prishtinë.
- 6.Myrtaj, N. (2007) Ndikimi i aktiviteteve kineziologjike në transformimin e aftësive lëvizore motorike te të rinjët e moshës
- 7.Rushiti,H.(1999).”Ndikimi i aktiviteteve kineziologjike në zhvillimin e disa karakteristikave psikosomatike te nxënësit”.Acta kineziologjike, Prishtinë.
- 8.Zeqa.,V. (2004). Struktura frontale dhe racionet ndërmjet disa dimensioneve antropometrike dhe aftësive të hendbollit ,punim magjistrature, Prishtinë 2004.



9. Aliu, M, (1997). Biomotorika , Tekst universitar. Universiteti i Prishtinës FKf, Prishtinë.
10. Aliu, M .(1991), Zhvillimi i disa karakteristikave morfologjike dhe motorike të popullatës shkollore dhe ndryshimet në ato karakteristika në varshmëri me moshën kronologjike“, Disertacion doktore, Sarajevë.
11. Mišigoj-Duraković, M. (2008). Kinantropologija, Biološki aspekti vježbanja. Kineziološki Fakultet Sveučilište Zagreb, Croatia.
12. Rexhepi, A. (2009). Mjekësia Sportive. Ministria e Shëndetësisë. Qendra e Mjekësisë Sportive dhe Rekreacionit. Kolegji EUS Eurosporti, Prishtinë, Kosovë.
13. Hasangjekaj, B (1988), Metodika e Edukatës Fizike, Prishtinë 1998
14. Gjinolli, E. (1982). Ndikimi i programeve të ndryshme të procesit mësimorë të ed.fizike në disa dimensione të statusit psiko-somatik të nxënësve të klasave të pesta të shkollave fillore, elan nr.10.1982 dhe nr.11.1984 Prishtinë.
15. Vuleta, D., Milanovic, D., Gruic, I., & Jukic, I., (2006)“ Mjerenje, vrednovanje o prezentacija kondicijske pripremljenosti u rukometu.

## 10. PARAQITJA GRAFIKE E REZULTATEVE TË VISEVE URBANE DHE RURALE



### 10.1. Rezultatet e nxënësve të SHMU “ Rasim Kiqina” Drenas















### 10.2. Rezultatet e nxënësve të SHMU “Shaban Polluzha” Koroticë–Drenas

